



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 690 / Prot.

Tiranë, më 21/07/2015

VENDIM
“ Për mospranimin e ankesës”

Nr. 43, datë 21 / 7 /2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën Nr. 690 Prot., datë 16.07.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Komunës Lukovë, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit”. Ankuesi/ Z. në cilësinë e kërkuarit ka kërkuar informacion, me kërkesat e datës 17.02.2015 dhe 02.04.2015 drejtuar autoritetit publik/ Komunës Lukovë, lidhur me :

1. Kontratat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të lidhura nga Komuna Lukovë për tokat e pandara, pyje dhe për kullotat prej fillimit e deri në fund të vitit 2014 së bashku me plan vendosjet e këtyre sipërfaqeve të dhëna me qira.
2. Praktikrat për kalimin e tokës bujqësore nga në përdorim në pronësi të fermerëve në të gjitha fshatrat e Komunës.

Rezulton se, Autoriteti Publik/Komuna Lukovë ka trajtuar kërkesën e ankuesit dhe nëpërmjet shkresës nr.335 Prot, datë 4.03.2015 ka informuar atë mbi objektin e kërkesës.

Nga dokumentacioni i administruar vërehet se, ankuesi ndaj përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik ka depozituar ankim pranë Zyrës së Komisionerit në datë 16.07.2015, në tejkallim të afatit të parashikuar në nenin 24/2 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, në të cilin shprehimisht thuhet “ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur ankuesi ka marrë njoftimin për refuzimin e informacionit ose ka kaluar afati i parashikuar në ligj për dhënien e informacionit”.

Në kushte të tilla, ankesa rezulton të jetë e pa bazuar në ligj dhe prova dhe si e tillë ajo nuk duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a)/ i) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Mospranimin e ankesës nr. 690 Prot., datë 16.07.2015 të Z. _____, ndaj Komunës Lukovë.
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot në datë 21.07.2015.

Besnik DERVISHT

KOMISIONERI

